



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 672, datë 08.11.2023

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES ALMA KODRALIU
PËR PERIUdhËN 2017 - 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares Alma Kodraliu, për periudhën 2017- 2019”, i hartuar nga relatore znj. Yllka Rupa,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares Alma Kodraliu, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE
VEPRIMTARISË PROFESIONALE

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE
PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI.**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtaren Alma Kodraliu në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes, gjyqtarja referuar objektit të mosmarrëveshjes, natyrës së çështjes (civile themeli, çështje tregtare, kërkesë civile), i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar dhe analitik të fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave të çështjes përbën pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit, në të cilën parashtrahet dhe në vijim përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me (i) shqyrtimin e kërkesave të palëve gjatë gjykimit për, marrjen e masës së sigurimit të padisë, shtim pakësim apo saktësim objekti¹ (ii) vlerësimi ligjor i gjykatës lidhur me elementë të kompetencës lëndore ose tokësore në shqyrtimin e çështjes², (iii) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesa të palëve për ndryshimin e ndërgjyqësisë, thirrjen në gjykim edhe të personave të trete, të paditur etj, (iv) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesat e palëve për pakësimin/saktësim e objektit të padisë.

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi të cilat lidhen me shqyrtimin e çështjeve të themelit përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqëruar me vlerësimin dhe analizën ligjore të gjykatës lidhur me këto elementë, posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, i jep qartësi vendimit dhe orienton lexuesin lidhur me elementë të tillë, si: objekti i padisë, shkaku ligjor i saj, ndërgjyqësia, zhvillimi i gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve, etj.

Pas përshkrimit dhe analizës së fakteve me natyrë procedurale, gjyqtarja parashtron dhe analizon në mënyrë të detajuar faktet thelbësore të çështjes, duke i integruar në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën, mbi të cilat gjyqtarja ka konkluduar lidhur me faktet konkrete. Në secilin vendim burim vlerësimi, faktet e çështjes janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë tepër të detajuar dhe të plotë, duke u shoqëruar në çdo rast me paraqitjen dhe analizën e provave të administruara në gjykim, në mbështetje të konkluzioneve të gjyqtarës lidhur me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja identifikon dhe përcakton qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes objekt shqyrtimi. Natyra e çështjes përcaktohet që në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit, referuar specifikave të çështjeve konkrete, siç janë rastet e çështjeve të seancës paraprake, në të cilat objekti i shqyrtimit rezulton të përcaktohet që në pjesën hyrëse të arsyetimit, duke orientuar edhe natyrën e procedimit të zhvilluar, si dhe faktet që do të jenë objekt vlerësimi në vijim të arsyetimit. Në këtë kontekst, në lidhje me detyrimin e gjykatës për përcaktimin e saktë të shkakut ligjor të padisë, gjyqtarja referon në një pjesë të vendimeve edhe vendimin unifikues nr.3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, duke u bërë në mënyrë të shprehur, e në disa raste, si pasojë e një analize ligjore të shkakut dhe objektit të padisë, posaçërisht në çështjet civile, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, duke cituar dhe analizuar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale,³ në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në

¹Vendimi nr.2476 date 16.03.2018, vendimi nr. 8912 date 30.12.2019,

²Vendimi nr. 168 date 17.01.2019, vendimi nr. 5048 date 04.06.2018, vendimi nr.716 date 06.02.2017

³ Vendimi nr. 7478, datë 15.09.2017; vendimi nr. 10322 datë 14.12.2018; vendimi nr. 6568, datë 09.10.2019 10668, datë 14.12.2017; vendimi nr. 7567, datë 24.09.2018; vendimi nr. 8245, datë 11.12.2019; dhe 8912, datë 30.12.2019.

analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

Sa i përket ligjit procedural:

Në çështjet civile, gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- *nenet 35/3, 36/1, 41, 42,45/1, 511/ç, 609 dhe 610 të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, referuar objektit të tyre ne pjesën me te madhe te vendimeve gjyqësore burim vlerësimi (çështje me objekt njohje bashkëpronar, pavlefshmëri kontratë dhurimi, pavërtetësi dokumenti, kundërshtim veprimesh përbarimore, njohje pronar, krijim servituti, pjesëtim pasurie, lirim dorëzim sendi, marrëdhënie pune, vërtetim fakti juridik, lëshim urdhri ekzekutimi, shpërblim demi pasuror dhe jo pasur etj);*
- *nenet 160 , 55 te K.Pr.C ku pasqyron vendimmarrjen ne lidhje me bashkimin e padive ne nj e çështje te vetme,⁴*
- *nenet 182 , 214 , 232, 259 te K.Pr.C ne funksion te argumentimit te vlerës provuese te pohimit gjyqësore⁵*
- *nenet 6,1, 17,28, 31 i K.Pr.C, ne lidhje me parime e përgjithshme te procesit gjyqësore civil si dhe koncepti juridik te padisë⁶*
- *nenet 179, 201 te K.Pr.C ne lidhje me pushimin e gjykimit për mosparaqitjet palëve,⁷*
- *nenet 520, 511 i K.Pr.C ne lidhje me institutin e titullit ekzekutiv ⁸*
- *neni185 të K.Pr.Civile, lidhur me pakësimin e objektit të padisë dhe bashkëndërgjyqësinë,⁹*
- *nenin 185 të K.Pr.Civile lidhur me ndryshimin e objektit të padisë, lidhur me ligjshmërinë e masës së sigurimit të padisë;*
- *nenet 105 dhe 106 të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e detyrimit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore referohet në të gjitha vendimet burim vlerësimi.*

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtari identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në shmangien e citimit apo të listimit të dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Referuar vendimeve civile burim vlerësimi konstatohet se:

Në vendimet civile (me objekt pavlefshmëri veprimi juridik, marrëdhënie pune, njohje pavërtetësi dokumenti, pavlefshmëri titulli ekzekutiv dhe kundërshtim veprimi përbarimor, njohje pronar, etj), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar si dispozitave materiale të Kodit Civil, Kodit të Punës ashtu edhe ligjeve të posaçme që kanë lidhje kryesisht me:

- *Zgjidhje kontratës se shitjes: gjyqtarja identifikon si dispozite ligjore materiale nenet 79,92,164, 419, 463, 659, 660, 663, 698 dhe 705, K. Civil lidhur me mënyrat e fitimit të pronësisë, konceptit të detyrimit dhe ekzekutimit të tij, konceptit juridik të kontratës, veprimit juridik dhe rastet e pavlefshmërisë së veprimit juridik, lirinë kontraktore, kushtet ligjore për ekzistencën e kontratës*

⁴.vendimi nr . 7478 date 15.09.2017

⁵.vendimi nr.,10381, date 07.12.2017,

⁶.vendimi nr . 5003 date 09.07.2029,

⁷.vendimet nr . 7568 date 24.09.2018

⁸.vendimi nr.11321 date 22.11.2017

⁹.vendimi nr . 2476 date 16.03.2018

si dhe elementët thelbësorë për kontratën e shitje, identifikon si dispozitë të zbatueshme nenin 93 të K. Rrugor, miratuar me ligjin nr.8378, datë 22.07.1998, ndryshuar me ligjin nr.9808, datë 24.09.2007, lidhur me ndryshimin e pronësisë së mjeteve nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.¹⁰

- *Përmbushje detyrimi dhe shpërblim demi*, gjyqtarja identifikon nenet 1050-1055 të K. Civil, që normojnë kontratën e huasë dhe kushtet e vendosura nga legjislatori për vlefshmërinë e saj.¹¹
- *Përmbushje detyrimi kontraktor konkretisht*, citon nenet 92, 94, 99, 163, 420, 422, 455, 660, 663, 681, 682, 690, 693, 698, 757, 850 dhe 463 të K. Civil, lidhur me veprimet juridike dhe pavlefshmërinë e tyre, pronësinë, detyrimet që burojnë nga kontratat, kushtet e nevojshme për lidhjen e kontratës, interpretimin dhe fuqinë juridike të kontratës, pasojat juridike në rastin e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore, ekzekutimin e detyrimit kontraktor, si dhe kontratën e shkëmbimit dhe atë të sipërmarrjes dhe si dispozitë të zbatueshme nenin 35 të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.¹²
- *Pavlefshmëri vendimi*, identifikon ligjin nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisë së qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”, VKM nr.63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujerave të ndotura”, VKM numrin .63, datë 27.01.2016”, VKM nr.660, datë 12.09.2007 “Për transferimin e aksioneve të shoqërisë të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësi të qeverisjes vendore” si dhe akte të tjera nënligjore që kanë rregulluar procedurat për riorganizimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sha. Citon dhe identifikon ligjin nr .9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, konkretisht nenet 137, 138, 144, 145 lidhur me respektimin e kritereve ligjore për vlefshmërinë e vendimeve të Asamblesë se Përgjithshme të shoqërisë tregtare. Identifikon nenet 3, 10, 108, 113, 117, 123, 124, 133, 186, 217, 218, 227 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, lidhur me konceptin e shoqërive tregtare, kontributin e themeluesve, kriteret ligjore për themelimin e shoqërive tregtare, shkaqet e pavlefshmërisë së themelimit si dhe procedurës së ndarjes së shoqërisë.¹³
- *Kthim shume* – referon nenin 12/2 dhe 13 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në lidhje me parashikimin e ndalimit të administratorit për lidhjen e marrëdhënieve që kanë të bëjë me interesa financiare të shoqërisë.¹⁴
- *Zgjidhjen e Aktmarrëveshjes për Kontratën e Garancisë*), gjyqtarja referon dispozitat materiale relevante për zgjidhjen e mosmarrëveshjes referuar cilësimit juridik të faktit të bërë nga ana e gjykatës dhe zbulimit të shkakut ligjor të padisë referuar parimeve të përgjithshme procedurale dhe përfundimeve të Vendimit Unifikues nr.3, datë 29.03.2012 të Gjykatës së Lartë. Konkretisht gjykata identifikon nenet 1113-1115, 1118, 1112, 1123 të K. Civil, që normojnë konceptin juridik të Kontratës së Sigurimit, elementët e vlefshmërisë së saj dhe pasojat juridike në rastin e mosrespektimit të këtyre elementëve. Identifikon nenet 660 dhe 690 të K. Civil, në lidhje me fuqinë juridike të kontratave dhe evidentimin e parimit të lirisë kontraktore.¹⁵

¹⁰ Vendimi nr. 7478 date 15.09.2017.

¹¹.vendimin nr. 10381, datë 07.12.2017

¹².vendimin nr . 10322, datë. 14.12.2018

¹³.vendimin nr . 2668, datë 21.03.2018

¹⁴.vendimin nr.8205, datë 10.02.2019

¹⁵.vendimin nr. 5003, datë 09.07.2019

- *Përmbushje e detyrimi*, gjyqtarja citon dispozitat ligjore materiale në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, dhe më konkretisht nenet 450, 541 dhe 542 të K. Civil, lidhur kamatat ligjore, kushtin penal dhe me sanksionin për përmbushjen e detyrimeve.
- *Pushimin e veprimeve përmbartimore*, gjyqtarja citon nenin 590 të dhe 600 të Kodit Civil, lidhur me institutin e dorëzansisë¹⁶
- Dëmshpërblim për shkak të marrëdhënieve të punës, gjyqtarja referon dispozita ligjore materiale dhe më konkretisht: nenin 141 të K. Punës (mbi llojin e kontratës së punës me apo pa afat), nenin 143 K. Punës (mbi afatin e njoftimit për përfundimin e marrëdhënies së punës), nenin 144 K. Punës (procedura e zgjidhjes së kontratës së punës), nenin 145 K. Punës (në lidhje me institutin e shpërblimit për vjetërsi) dhe nenin 153 të K. Punës (mbi shkaqet e justifikuar të zgjidhjes së marrëdhënies së punës nëse zgjidhja është bërë në mënyrë të menjëhershme) si norma relevante këto për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi në lidhje me të gjitha kërkimet e palës paditëse.¹⁷
- *Shpërblim demi pasuror jopasuror*, gjyqtarja subjekt vlerësimi, citon dispozitat ligjore materiale në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, dhe më konkretisht nenin 608, 609, 625, 641 të K. Civil mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore dhe elementët e dëmit jashtëkontraktor. Citon dispozitat ligjore të ligjit të posaçëm nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe rregulloren nr. 53 datë 25.06.2009 e dalë në zbatim të ligjit të posaçëm citon ligjin nr. 10031/2008 “Për shërbimin përmbartimor”.¹⁸
- *Konstatim i pavlefshmërisë absolute të kontratës së dhurimit*, gjyqtarja identifikon si dispozita të zbatueshme nenin 3 pika 3 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe nenin 90 dhe 94 të K. Familjes, lidhur me administrimin e bashkësisë ligjore dhe të drejtën e ngritjes së padisë në rastin kur pëlqimi i bashkëshortit nuk është marrë gjatë kryerjes së një veprimi juridik.¹⁹
- *Përmbushje detyrimi*, gjyqtarja citon dispozitat ligjore materiale në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, dhe më konkretisht nenet 476, 479, 698 dhe 690 të K. Civil, lidhur me ekzekutimin e detyrimeve, përgjegjësinë për mosekzekutimin e detyrimeve, si dhe fuqinë juridike të kontratave²⁰
- *Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit*, citon nenin 510/e të K.Pr.Civile

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

Në tërësi, ajo që evidentohet është aftësia e gjyqtarës për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në

¹⁶. vendimin nr. 5582, datë 28.06.2018

¹⁷. vendimet me nr. 6568, datë 09.10.2019, nr. 10668, datë 14.12.2017, nr. 7567, datë 24.09.2018 dhe nr.8245, datë 11.12.2019)

¹⁸.vendimin nr .2537, datë 19.03.2018 apo në vendimin nr .3369, datë 09.05.2019

¹⁹.vendimin nr . 5048, datë 04.06.2018

²⁰.vendimin nr . 170, datë vendimi 17.01.2019

përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyesimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit aftësia e gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale, ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Tipar karakteristik i gjyqtarit është se në çdo rast citimi ose referimi i dispozitave është shoqëruar me interpretimin e tyre në mënyrë abstrakte, para aplikimit mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm

Në vendimet civile, përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtarja:

Në çështjen me objekt zgjidhje kontrate:

- Interpreton nenin 663 të K. Civil duke analizuar katër elementët për ekzistencën e një kontrate: 1) *pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin* 2) *shkaku i ligjshëm* 3) *objekti* 4) *forma e kërkuar nga ligji*. Në vijim gjykata interpreton në mënyrë sistematike nenin 663 të K. Civil me nenin 705 të po këtij Kodi, në funksion të verifikimit të elementëve të vlefshmërisë së kontratës së shitblerjes, lidhur mes palëve. Interpreton në mënyrë sistematike nenet 79 dhe 92 të K. Civil duke dhënë përkufizimin e veprimit juridik dhe më pas analizimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik në rastin kur ky i fundit bëhet në marrëveshje mes palëve pa patur qëllim që të sjell pasoja juridike.
- Interpreton nenet 698 dhe 700 të K. Civil me qëllim analizimin e mos përmbushjes së detyrimit, pasojat juridike të saj si dhe kërkesat ligjore për zgjidhjen e marrëdhënies juridike mes palëve kontraktuese në rastin e mospërmbushjes së detyrimit. Interpreton nenin 164 të K. Civil lidhur me kalimin e pronësisë mbi sendet individualisht të përcaktuara.²¹

Ne çështjet me objekt përmbushje detyrimi dhe shpërblim dëmi:

- Interpreton nenet 1050-1055 të K. Civil, që normojnë kontratën e huasë dhe kushtet e vendosura nga legjislatori për vlefshmërinë e saj.²²

Ne çështjet me objekt përmbushjen e detyrimit kontraktor gjyqtarja:

²¹.vendimi nr. 7478, datë 15.09.2017

²².vendimi nr .10381, datë 07.12.2017

- Interpreton në mënyrë sistematike nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1, Protokollin 1 i KEDNJ, lidhur me të drejtën e pronës. Në këtë kontekst gjyqtarja referon në jurisprudencën e GJEDNJ, konkretisht në çështjet *Markckx kundër Belgjikës*, *X kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, *çështjen Vrioni dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, *Beshiri kundër Shqipërisë*. Gjithashtu, në funksion të argumentimit se mbrojtja që ofron nenin 1, Protokollin 1 i KEDNJ është edhe mbrojtja e personit nga ndërhyrjet e pajustificuara të shtetit, gjyqtarja referon në çështjen *Pressos Compania Naviera SA dhe të tjerë kundër Belgjikës*. Me qëllim arritjen e një konkluzioni, nëse e drejta që gëzon paditësi mbi ndërtesën e vetëdeklaruar në organet kompetente gëzon mbrojtje në kuptim të nenit 1, Protokollin 1 i KEDNJ, gjyqtarja bën një interpretim historik të ligjit nr .9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në qëllimin e këtij ligji. Duke interpretuar në mënyrë sistematike nenet 79 dhe 663 të K. Civil, lidhur me kushtet thelbësore që duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative që kontrata të jetë e vlefshme, gjykata referon në Vendimin Unifikues nr.1, datë 06.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nenin 99 të K. Civil, për të arritur në konkluzionin nëse lidhja e kontratës është bërë nga një prej palëve kontraktuese në kushtet e nevojës së madhe .Interpreton gjithashtu nenin 420 të K. Civil, lidhur me detyrimet kontraktore, në funksion të argumentimit se në K. Civil janë sanksionuar në mënyrë të detajuar modalitetet e përmbushjes së detyrimeve të marra përsipër nga palët, të cilat duhet të tregojnë korrektësi dhe të sillen ndaj njëra tjetrës me mirëbesim, paanësi dhe sipas kërkesave të arsyes. Interpreton nenin 12 të K.Pr.Civile, lidhur me institutin e barrës së provës, duke trajtuar faktet krijuese dhe shuese .²³

Në çështjet me objekt pavlefshmëri vendimi, gjyqtarja:

- Interpreton dispozita të ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisë së qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë” me dispozita të akteve nënligjore që kanë rregulluar procedurat për riorganizimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sha. Interpreton ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, lidhur me Asamblenë e Përgjithshme si organin e shoqërisë, e cila ka të drejtën dhe detyrën për marrjen e një sërë vendimesh që përcaktojnë politikën tregtare të shoqërisë dhe ecurinë e saj. Në këtë kontekst gjyqtarja interpreton nenet 137 dhe 138 të ligjit, në funksion të analizimit të mënyrës dhe afatit të thirrjes së Asamblesë së Ortakëve në shoqërinë tregtare si dhe pasojat juridike në rast të mosrespektimit të kësaj procedure. Gjyqtarja duke analizuar afatin e thirrjes së Asamblesë së Ortakëve referon në parimin e së drejtës së informimit të ortakëve, parim i sanksionuar në nenin 15 të ligjit për shoqëritë tregtare. Interpreton në mënyrë literale dhe sistematike nenet 3, 10,108,113, 117, 123, 124, 133, 186, 217, 218, 227 të ligjit numrin .9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, lidhur me konceptin e shoqërive tregtare, kontributin e themeluesve, kriteret ligjore për themelimin e shoqërive tregtare, shkaqet e pavlefshmërisë së themelimit si dhe procedurës së ndarjes së shoqërisë.²⁴

Në çështjet me objekt kthim shume, gjyqtarja:

- Interpreton nenin 12/2 të ligjit numrin .9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në lidhje me parashikimin e ndalimit të administratorit për lidhjen e marrëdhënieve që kanë të bëjë me interesa financiare të shoqërisë. Në këtë kontekst gjykata e interpreton edhe me qëllimin e ligjit, i cili është të mbrohet veprimtaria e shoqërisë nga veprimet jo korrekte të mundshme të administratorit, mbrojtja e ortakëve dhe e vetë shoqërisë.²⁵

²³.vendimi nr. 10322, datë 14.12.2018

²⁴.Vendimi nr . 2668, datë 21.03.2018

²⁵. vendimin nr . 80205, datë 10.02.2019

Në çështjet me objekt zgjidhjen e Aktmarrëveshjes për Kontratën e Garancisë, gjyqtarja:

- Interpreton nenet 1113-1115, 1118, 1112, 1123 të K. Civil, që normojnë konceptin juridik të Kontratës së Sigurimit, elementët e vlefshmërisë së saj dhe pasojat juridike në rastin e mosrespektimit të këtyre elementëve. Interpreton në mënyrë sistematike nenet 660, 690 të K. Civil me nenin 1125 të po këtij Kodi në lidhje me fuqinë juridike të kontratave dhe evidentimin e parimit të lirisë kontraktore duke arritur në përfundimin se ligji jo vetëm lejon por edhe përcakton edhe detyrimin për pagesën e primit si një detyrim paraprak. Në këtë përfundim gjyqtarja arrin jo vetëm nën interpretimin e Kontratës së Garancisë në rastin objekt gjykimi, dhe dispozitave ligjore të identifikuara, por edhe përfundimet e Vendimit nr.11, datë 16.01.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në funksion të konkluzionit se pagesa e primit pasi ka ndodhur ngjarja nuk mundet kurrësi ti jap fuqi ligjore të pavlefshme pasi në vetvete edhe ky pagim nuk ka asnjë efekt të ligjshëm.²⁶

Në çështjen me objekt pushimin e veprimeve përmbartimore, gjyqtarja:

- Interpreton nenet 590 të Kodit Civil, lidhur me institutin e dorëzarisë, duke bërë dallimin midis saj dhe mjeteve të tjera të përmbushjes së detyrimit si pengu, hipoteka.
- Interpreton nenin 600 të Kodit Civile, lidhur me shuarjen e dorëzarisë, duke përcaktuar natyrën e këtyre afateve dhe pasojën që sjell në humbjen e të drejtës subjektive të kreditorit, nenet 515 dhe 131/ç dhe 133 të Kodit Civil, lidhur me ndërprerjen e parashkrimit me paraqitjen e kërkesës për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor, arbitrazhit përkatës apo çdo titulli ekzekutiv tjetër.²⁷

Në çështjet me objekt dëmshpërblim për shkak të marrëdhënieve të punës, gjyqtarja:

- Referuar interpretimit literal të bërë dispozitës materiale (nenit 141 dhe 143 të K. Punës), dhe rrethanave të faktit. Interpreton dispozitën përkatëse (nenin 153 të K. Punës) duke analizuar në përputhje me faktet, kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative që të legjitimojnë punëdhënësin që të zgjidhë në mënyrë të menjëhershme kontratën e punës me punëmarrësin. Në funksion të interpretimit të kësaj dispozite rezulton se gjyqtarja referon në parimin e mirëbesimit në marrëdhëniet e punës si dhe zbatimit të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale, në interpretim të neneve 11/1, 22-31 të K. Punës. Interpreton në mënyrë sistematike nenet 37/2, 144, 154/3 të Kodit të Punës, lidhur me procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës si dhe barrën e provës duke analizuar në mënyrë të detajuar provat shkresore, mbi të cilat provohen faktet e kërkimeve apo pretendimeve të palëve në gjykim.

Në çështjet me objekt pavlefshmëri titulli, gjyqtarja

- Duke vlerësuar pretendimet e palëve ndërgjyqës si dhe provat shkresore, të administruara në gjykim, gjykata ka analizuar shkakun ligjor në referencë të nenit 16 të K.Pr.Civile si dhe në zbatim të Vendimit Unifikues nr.03, datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në këtë kontekst gjykata interpreton nenin 609 të K.Pr.Civile, duke analizuar se shkakun ligjor i padisë është së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv është qëndron në të drejtën e debitorit, që parashikohet në nenin 609 të K.Pr.Civile për tu çliruar nga një detyrim, i cili rrjedh nga titulli ekzekutiv, për shkak të mospërputhjes ndërmjet realitetit që përfaqëson titulli ekzekutiv, me realitetin që ekziston efektivisht.
- Në funksion të qëndrimit se në çdo rast objekti i kërkimit me padi duhet të përcaktojë qartë se përse titulli ekzekutiv duhet të deklarohet i pavlefshëm, gjykata referon në praktikën gjyqësore të mbajtur nga Gjykata e Lartë, duke cituar Vendimin nr.43, datë 31.11.2013 dhe nr.6, datë 10.01.2012.
- Interpreton mbi faktet e çështjes nenin 81 të K. Familjes, lidhur me detyrimet e bashkëshortëve ndaj bashkësisë ligjore.

²⁶vendimin nr. 5003, datë 09.07.2019.

²⁷.vendimin nr . 5582, datë 28.06.2018

Në çështjet me objekt shpërblim dëmi në të cilën bëjnë pjesë 4 nga vendimet burim vlerësimi²⁸ gjyqtarja :

- Ka referuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke u ndalur në vendimin Moroce vs. Francës, Lingens vs. Austrisë, Onorato vs. Italisë si dhe në çështjen Peruzzi vs. Italia nr.39294/09, datë 30 qershor 2015. Gjithashtu, në këtë vendim konstatohet se gjykata referon në parimin e proporcionalitetit, duke iu referuar në mënyrë specifike balancës së lirisë së shprehjes me të drejtën e mbrojtjes së reputacionit dhe vlerësuar prevalimin e të parës pasi kufizimi i saj në rastin konkret do të cenonte në mënyrë të drejtpërdrejte funksionimin e një shteti demokratik.²⁹
- Referuar interpretimit të dispozitave materiale, neneve 608 dhe 609 të K. Civil dhe dispozitave të ligjit të posaçëm nr.10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, gjykata në analizën juridike për të përcaktuar nëse është i mbështetur pretendimi i paditësit për shpërblimin e dëmit, ndalet në mënyrë të detajuar jo vetëm në interpretimin abstrakt të normës relevante (nenet 608 e vijues të K. Civil), por dhe tek ligji i posaçëm nr.10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, duke përcaktuar se cilat janë kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative për të provuar ekzistencën e përgjegjësisë jashtëkontraktore, dhe për pasojë shpërblimin përkatës në të gjitha figurat e dëmit pasuror dhe jo pasuror. Në këtë kontekst, në mënyrë të veçantë gjykata ndalet në interpretimin historik të legjislacionit të posaçëm që do të zbatohet për kryerjen e vlerësimeve të dëmeve materiale dhe jomateriale duke analizuar se me hyrjen në fuqi të të ligjit të posaçëm nr.10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, në bazë dhe zbatim të tij u miratua dhe Rregullorja numrin .53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”. Në mënyrë specifike, gjykata ndalet në interpretimin e nenit 11/2 të ligjit nr.10076/2009, lidhur me rastet e përjashtimit nga sigurimi dhe e drejta për të kërkuar dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jopasuror gjithashtu po nr ketë vendim gjyqtarja interpreton nenin 50 të K. Familjes, lidhur me të drejtat dhe detyrimet mes bashkëshortëve.³⁰

Në çështjet me objekt lirim dorëzim sendi, gjyqtarja:

-Interpreton në mënyrë literale nenin 296 të K. Civil (*padinë e rivendikimit*), në drejtim të përcaktimit të fakteve juridike që kërkohet të provohen në rastin e padisë së kërkimit të sendit, si ekzistenca e të drejtës subjektive të pronës së paditësit dhe posedimi i paligjshëm i të paditurit pra sa i përket të drejtës absolute që ka pronari për të ngritur padinë e rivendikimit kundër cdo personi nëse kjo e drejtë i është cenuar në mënyrë të paligjshme, gjithashtu citon dhe referon përmbajtjen e vendimin nr. 5 date 31.05.2011 te Kolegjeve te Bashkuara, sa i takon te drejtës se pronarit për të ngrit padinë si mjet mbrojtës ndaj cenimi te drejtës se pronësisë.

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm sa i përket aspekteve të themelit të çështjes, por edhe atyre procedurale, në rastet kur ngrihen çështje të procedurës, apo kur është vetë dispozita

²⁸vendimet nr . 7292, datë 11.09.2017,vendimi nr. 4644, datë 23.05.2018,vendimi nr. 2537, datë 19.03.2018 si dhe vendimin nr. 3369, datë 09.05.2019

²⁹.vendimi nr .4644, datë 23.05.2018

³⁰.vendimi nr . 2537, datë 19.03.2018.

procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh në çështjet në të cilat është vendosur pushimi i gjykimit.

-Interpreton në mënyrë sistematike dispozitat procedurale civile (*nenet 6, 16/1, 28, 17, 31 të K.Pr.Civile*), në lidhje me parimet e përgjithshme të procesit gjyqësor civil në funksion të konkluzionit se gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj udhëhiqet gjithmonë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor.

Interpreton nenin 12 të K.Pr.Civile, lidhur me institutin e barrës së provës, duke trajtuar faktet krijuese dhe shuese.

-Në funksion të argumentimit të vendimit të ndërmjetëm për marrjen e provave nga të tretët gjyqtarja interpreton nenin 14 dhe 154 të K.Pr.Civile duke analizuar detyrën e gjykatës për një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes si dhe kthimin e akteve nga gjykata në rastin kur padia vlerësohet me të meta.

-Në çështjen civile me objekt kundërshtim veprimesh përmbartimore, gjyqtarja interpreton në mënyrë sistematike *nenet 41, 61, 609 dhe 610 të K.Pr.Civile*.

-Interpreton nenet e K.Pr.Civile për përcaktimin e të drejtës së padisë dhe elementëve të saj, duke iu referuar në mënyrë të posaçme padisë së njohjes (neni 32/c), etj.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në shumë vendime burim vlerësimi (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- *Vendimit Unifikues nr.3, datë 29.03.2003 të Gjykatës së Lartë* lidhur me shkakun e padisë dhe nisur nga *parimin iuria novit curia (gjykata e njeh ligjin)* çmon qartësinë dhe kuptueshmërinë e objektit të kërimit të pretenduar.
- Interpreton në mënyrë sistematike nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1, Protokoli 1 i KEDNJ, lidhur me të drejtën e pronës. Në këtë kontekst gjyqtarja referon në jurisprudencën e GJEDNJ, konkretisht *në çështjet Markckx kundër Belgjikës, X kundër Republikës Federale të Gjermanisë, çështjen Vrioni dhe të tjerë kundër Shqipërisë, Beshiri kundër Shqipërisë*. Gjithashtu, në funksion të argumentimit se mbrojtja që ofron nenin 1, Protokoli 1 i KEDNJ është edhe mbrojtja e personit nga ndërhyrjet e pajustificuara të shtetit, gjyqtarja referon në çështjen *Pressos Compania Naviera SA dhe të tjerë kundër Belgjikës*.
- Përfundimi nëse e drejta që gëzon paditësi mbi ndërtesën e vetëdeklaruar në organet kompetente gëzon mbrojtje në kuptim të nenit 1, Protokoli 1 i KEDNJ, gjyqtarja bën një interpretim historik të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", duke u ndalur në mënyrë të veçantë në qëllimin e këtij ligji.
- Në funksion të arsyetimit të vendimit të ndërmjetëm për pranimin e kërkesës për ndryshimin e objektit të padisë, gjykata referon në vendimin *Gubisch Maschinenfabrik KG v Palumbo*, në të cilën GJEDNJ është shprehur: "*Kur themi që paditë duhet të jenë të njëjta, kemi parasysh të njëjtën mosmarëveshje dhe nuk do të thotë që dy paditë të jenë në mënyrë identike...*"
- Me qëllim për të analizuar natyrën obliguese të zbatimit të procedurës, gjyqtarja në vendimin nr.6568, datë 09.10.2019 referon në Konventën nr.158 të ONP "*Për ndalimin e punësimit me iniciativën e punëdhënësit*" (*nenet 8 dhe 9 të saj*).
- Në çështjet me objekt shpërblim dëmi, gjyqtarja në funksion të analizimit të së drejtës së shprehjes dhe kufizimit të saj, ka referuar në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të

Drejtave të Njeriut, duke u ndalur në vendimin *Moroce vs. Francës, Lingens vs. Austrisë, Onorato vs. Italisë si dhe në çështjen Peruzzi vs. Italia nr .39294/09, datë 30 qershor 2015.*

- Vendimin unifikues nr.12/2007 të Gjykatës së Lartë, mbi kushtet dhe kriteret thelbësore për ngritjen e padisë për të vënë në vend të drejtat që rrjedhin nga dëmet në fushën e transportit rrugor. Në funksion të qëndrimit se Rregullorja nr.53, datë 25.06.2009 "*Për trajtimin e dëmeve që mbuloohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.*" është në përputhje me Vendimin Unifikues nr.12, datë 14.09.2007, gjykata pasqyron një qëndrim të Gjykatës Kushtetuese (*pa cituar numër vendimi*), në funksion të argumentimit se gjykatat dhe ekspertët i referohen kriterëve teknike tabelare të parashikuara për këtë qëllim, apo për situata të ngjashme në akte normative.
- *Ne çështjen me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së dhurimit*), gjyqtarja Interpreton në mënyrë sistematike nenet 73, 74/ç dhe 76 të K. Familjes lidhur me prezumimin ligjor të bashkësisë ligjore, si dhe prezumimin mbi pasurinë e përbashkët. Interpreton nenet 90 dhe 94 të K. Familjes, duke analizuar mbi faktet e çështjes të drejtën e administrimit të zakonshëm të pasurisë, si dhe të drejtën e ngritjes së padisë në rastin kur pëlqimi i bashkëshortit nuk është marrë gjatë kryerjes së një veprimi juridik.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i përhershëm i gjyqtarës që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtarja njeh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- referon **parimin e disponibilitetit** të padisë në drejtim të vlerësimit të së drejtës së paditësit për të hequr dorë nga gjykimi,
- **parimin e procesit të rregullt ligjor** nëpërmjet zhvillimit të një hetimi gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm (nenet 14 dhe 16 të K.Pr.Civile).
- **parimin e proporcionalitetit**, duke iu referuar në mënyrë specifike balancës së lirisë së shprehjes me të drejtën e mbrojtjes së reputacionit dhe vlerësuar prevalimin e të parës pasi kufizimi i saj në rastin konkret do të cenonte në mënyrë të drejtpërdrejte funksionimin e një shteti demokratik
- **parimin e procedural të kontradiktoritetit**, gjyqtarja evidenton parimet themelore të procesit gjyqësor të pasqyruara në nenet 5, 8 të K.Pr.Civile
- **parimi themelor i te drejtës kontraktore Pacta Sunt Servanta**, i cili mishërohet në mënyrë eksplicite në nenin 690 i KCivil,

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Ndërkohë dispozitat e ligjit material rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet një kujdes i shtuar i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegjeve të Bashkuara dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i rrallë i termave/shprehjeve në gjuhën latine, por gjithmonë kuptimi i tyre jepet në gjuhën shqipe (*Pacta Sunt Servanta*), duke i bërë të kuptueshëm për lexuesin. Po ashtu, në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit, apo si pasojë e referimit në ligje të posaçëm me karakter specifik, përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij, ose rezulton i qartë nga konteksti i arsytimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Në arsytimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezulton në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsytimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsytimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Vendimet në përgjithësi janë të organizuara në paragrafë dhe nënparagrafë duke u lidhur në mënyrë kronologjike me njëri tjetrin dhe një pjesë e këtyre vendimeve janë të organizuara në nënndarje, të identifikuar me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit³¹.

³¹ vendimi nr. 10322 date 14.12.2018; vendimi 2668 date 21.03.2018; vendimi nr. 8205 date 10.12.2019; vendimi nr.8245 date 11.12.2019, vendimi nr. 4644 date 23.05.2018, vendimi nr. 8912 date 30.12.2019.

Në vendimet përfundimtare të vëzhguara, evidentohet se gjyqtarja pasqyron dhe merr në analizë elementët proceduralë, si: kompetenca, juridiksioni (*jo në të gjitha vendimet*), të drejtat e palëve, njoftimi i tyre, trajtimin e kërkesave të palëve ndërgjyqëse gjatë procesit gjyqësor dhe vendimmarrjet respektive të gjykatës lidhur me to, pavarësisht se nga përmbajtja e vendimit, jo në çdo rast këta elementë kanë qenë të diskutueshëm nga palët apo rrethanat e çështjes. Në vendimet burim vlerësimi pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e palëve, të cilat merren në analizë nga gjyqtarja.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Qartësia, koncizitetit dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet, në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe fakteve thelbësore të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, të cilat vijnë gjithnjë si pasojë e procesit të arsyetimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkuese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuar me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë dhe në disa raste të listuara formalisht me tituj, si: procedura, rrethanat e faktit dhe pretendimet e palëve, legjislacioni i zbatueshëm dhe vlerësimi dhe analiza juridike e gjykatës, në të cilën në mënyrë të detajuar analizon: (i) elementët proceduralë të vlerësuar nga gjykata (juridiksioni, kompetenca), vlerësimi për kërkesat procedurale të palëve, së bashku me argumentet për vendimmarrjen respektive të gjykatës lidhur me to; (ii) faktet thelbësore të çështjes, të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, (iii) pretendimet e palëve gjatë gjykimit, (iii) ligjin e zbatueshëm, duke u ndalur jo vetëm tek dispozitat materiale civile, por edhe ato të ligjit të posaçëm, ku të referon fakti juridik civil për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe (iv) vlerësimi i gjykatës, në të cilin gjyqtarja merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet gjithashtu se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës mbi padinë e vënë në lëvizje nga paditësi (pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë, pushimin e gjykimit), por njëkohësisht edhe se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, Po kështu, vendimet përgjithësisht janë të strukturuar në paragrafë dhe nëndarje, çka lehtëson kuptueshmërinë e arsytimit të gjykatës për çdo pretendim të ngritur, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton një nivel shumë i mirë arsytimi, gjithnjë i detajuar, i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin civil si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale (*kryesisht çështje të kompetencës lëndore dhe tokësore, ndryshimin e ndërgjyqësisë, ndryshimin e objektit të padisë, etj.*).

Arsytimi i vendimeve përfundimtare ndjek një organizim funksional dhe zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material civil, duke integruar qartë faktet me provat e administruara dhe aplikimin e ligjit mbi faktet e çështjes konkrete, në shërbim të konkluzioneve të arritura për zgjidhjen e çështjes. Evidentohet kujdesi që tregon gjyqtarja në arsytim, për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me natyrën e mosmarrëveshjes/çështjes dhe zgjidhjen e saj. Gjyqtarja evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar analizën juridike dhe duke zhvilluar argumentimin logjik të saj, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes, duke treguar kujdes të posaçëm për evidentimin dhe argumentimin e marrëdhënies shkak-pasojë, në përjasjen e ligjit me faktet konkrete. Arsytimi i vendimeve është i qartë, i plotë

dhe gjithëpërfshirës, duke i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Në çështjet civile gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, p.sh: (i) insitutin juridik të parashkimit, duke analizuar elementët e tij thelbësorë : *kalimin e një periudhe të caktuar kohore dhe mosveprimin e titullarit për të ushtruar këtë të drejtë.*; (ii) Institutit juridik të shpërblimit, *në rastet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, duke analizuar në mënyrë të posaçme elementët e kontratës së punës*, formën e saj, procedurën dhe afatet e zgjidhjes së kontratës, shkaqet e justifikuara, pasojat që vijnë nga mosrespektimi i dispozitave ligjore nga ana e punëdhënësit, etj.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi (*me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj*). Pretendimet e palëve gjithnjë janë marrë në shqyrtim dhe analizuar, duke u dhënë një përgjigje të argumentuar dhe duke u analizuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsyetimit tërësor.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të vetë zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtares në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit, si dhe mbështetja e tij në qëndrimet e praktikës gjyqësore, duke pasuruar arsyetimin e vetë gjyqtares. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, në shërbim të zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Nivelin e vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares Alma Kodraliu në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe

kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 627 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi (325 çështje në vitin 2017, 150 çështje në vitin 2018 dhe 152 çështje në vitin 2019), të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “tregtare pa palë kundërshtare” dhe “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, se rezulton se gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 627 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 441 çështje janë shqyrtuar jashtë afatit ligjor dhe 192 janë shqyrtuar brenda këtij afati. Sa më sipër, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (gjithsej 441 çështje), me numrin e çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat ligjor (627 çështje), gjyqtarja Alma Kodraliu rezulton që të ketë gjykuar 70.3 % të çështjeve me afat ligjor jashtë këtij afati.

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat dhe burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 21 çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, rezulton se:

- Në tabelën me nr.1 të të dhënave statistikore, viti 2017 për çështjet e kategorisë “civile me palë kundërshtare” rezultojnë se janë gjykuar 22 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor (çështje me objekt kundërshtim veprimesh përmbarimor sipas nenit 610 të K.Pr.Civile), ndërkohë të gjitha çështjet e tjera në këtë tabelë kanë të parashikuar afat standard minimal kohor konform vendimit nr.261/2 të ish KLD-së.). Nga këto 22 çështje, 14 prej tyre janë gjykuar jashtë afatit ligjor dhe 8 çështje brenda këtij afati.

Ajo çfarë u konstatua është se për çështjen ne nr. rendor 155, kemi si datë regjistrimi 19.06.2017 dhe shortuar gjyqtares me date 28.09.2017 dhe data e vendimit 09.10.2017, dhe me afat gjykimi 112 ditë e llogaritur ne të dhënave statistikore por siç shihet nëse marrim përllogaritjen e afatit të gjykimit nga data shortimit deri në dhënien e vendimi ajo që rezultojnë është 11 ditë dhe konkluzioni është që kjo çështje konsiderohet si e përfunduar brenda afatit ligjor 20/ditor. Po e njëjta gjë konstatohet dhe ne po këtë tabelë por ne nr. rendor 146, për çështjen si date regjistrimi kemi datën 18.05.2017, shortuar gjyqtares me date 23.5.2017 dhe data e vendimit 08.06.2017, dhe me afat gjykimi 21 ditë e llogaritur në bazë dhënave statistikore por siç shihet nëse marrim përllogaritjen e afatit të gjykimit nga data shortimit duke zbritur 5 ditë deri në dhënien e vendimit ajo që rezulton është 16 ditë. Pra nuk është përgjegjësi e gjyqtares që çështja regjistrohet disa dite (4-5 ditë) para se ti caktohet me short për shqyrtim dhe kjo vonësë i përllogaritet në kohëzgjatjen e gjykimit

- Në tabelën me nr.2 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*civile pa palë kundërshtare*”, rezulton se janë gjykuar 251 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor (çështjet me objekt lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për të cilën sipas ligjit të kohës parashikohet një afat prej 5 ditësh për përfundimin e tyre apo çështje me objekt lejim për të votuar), nga të cilat 224 janë gjykuar jashtë afatit ligjor dhe 27 brenda këtij afati.

Nga kjo tabele rezultojnë rreth 32 çështje të cilat i zbriten nga numri i çështjeve që janë gjykuar jashtë afatit ligjor pasi rezultoi se ato janë brenda ose në tejkallim të papërfillshëm të afatit ligjor ose gjyqtarës i është caktuar me short shume ditë pasi është regjistruar çështja . Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe konkretisht tabelës nr.2, viti 2017, rezulton se: çështjet me numër rendor 32, 34, 36 , 89 dt. regjistrimi 17.03 dhe dt. shorti 24.03.2017 date vendim po 24.03.2017), 90 (dt. regjistrimi 17.03 dhe datën shorti 24.03.2017 date vendim po 24.03.2017), dhe me numrin rendor 132,133,136 vërehet po e njëjta situatë ku datat e regjistrimit të çështjes deri në atë shortimit të gjyqtarës variojnë me diferencë nga 4-5 ditë ndërkohë që vendimmarrja është brenda 1-2 ditëve apo 5 ditëve nga caktimi i shortit. Po e njëjta gjë vërehet dhe tek çështjet nr.rendor, 165, 178, 184, 185, 187-191, 221-227, 231, 239 dhe 277 ku afati ligjor tejkalohet vetëm me një ditë.

- Në tabelën me nr.10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar 52 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor (me objekt caktim/zëvendësim mase sigurimi apo rivlerësim mase sigurimi), nga të cilat 8 çështje janë gjykuar jashtë këtij afati dhe 44 çështje janë gjykuar brenda këtij afati .

Në total rezulton se gjyqtarja për vitin 2017 sipas statistikave ka gjykuar 325 çështje, për të cilat ligji parashikon afat ligjor (nga të cilat 212 prej tyre janë gjykuar jashtë afatit ligjor) dhe 239 çështje me afat standard minimal.

Për vitin 2018 sipas të dhënave në raportin analitik referuar të dhënave statistikore. gjyqtarja ka gjykuar 89 çështje jashtë afatit ligjor. Më konkretisht konstatohet se:

- Në tabelën me nr. 2 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*civile pa palë kundërshtare*”, rezulton se janë gjykuar 3 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor (çështjet me objekt marrje mase të përkohshme apo kërkesë me objekt kundërshtim veprimi përmbarrimor), nga të cilat 2 janë gjykuar jashtë afatit ligjor dhe 1 brenda afatit ligjor.

Në tabelën e sipërcituar për çështjet me nr rendor. 3 dhe nr rendor 12 , konstatohet se afati i gjykimit i llogaritur është 7 ditë d.m.th. në tejkallim me dy ditë nga afati i parashikuar ligjor por duke iu referuar datave të shortit të çështjeve që është përkatësisht 3 dhe 4 ditë pas datës së regjistrimit dhe vendimmarrja pas 2 dhe 3 ditë me marrjen e çështjes së shortuar nga gjyqtarja arrijmë në konkluzionin se këto 2 çështje janë gjykuar brenda afatit të parashikuar ligjor konkretisht 3 dhe 2 ditëve .

- Në tabelën me nr.6 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*tregtare pa palë kundërshtare*”, rezulton se janë gjykuar 132 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor (kryesisht çështjet me objekt regjistrim/depozitim aktesh, për të cilat ligji parashikon afat 15 ditë për shqyrtimin e tyre), nga të cilat 79 janë gjykuar jashtë afatit ligjor dhe 53 brenda afatit ligjor.

Në tabelën e sipërcituar për çështjet me numrin rendor. 2, 5,15, 16, 21, 27, 29, 60, 72, 90, 91, dhe numrin rendor 96-98, konstatohet se afati i gjykimit i llogaritur për këto çështje varion nga 16-19 ditë d.m.th. në tejkallim me 1-3 ditë nga afati i parashikuar ligjor 15 ditë. Tejkallimi i afatit me tre ditë është pikërisht në rastet kur shortimit i çështjes behet 4 deri në 7 pasi çështja është regjistruar dhe kohëzgjatja e gjykimit deri në datën e vendimmarrjes rezulton brenda afatit ligjor të parashikuar. Përfundimisht zbrësim 14 çështje nga totali i çështjeve që janë gjykuar jashtë afatit ligjor sipas të dhënave nga raporti analitik.

Pra sa me sipër për vitin 2018 sipas statistikave rezulton se gjyqtarja ka gjykuar 150 çështje, për të cilat ligji parashikon afat ligjor (nga të cilat 73 prej tyre janë gjykuar jashtë afatit ligjor) dhe 268 çështje me afat standard minimal.

Gjyqtarja subjekt vlerësimi për vitin 2019 ka gjykuar 106 çështje jashtë afatit ligjor referuar të dhënave statistikore. Më konkretisht konstatohet se:

- Në tabelën me nr.1 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*civile me palë kundërshtare*” rezultojnë se janë gjykuar 12 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor (çështje me objekt kundërshtim veprimesh përmbarimor sipas nenit 610 të K.Pr.Civile), ndërkohë të gjitha çështjet e tjera në këtë tabelë kanë të parashikuar afat standard minimal kohor konform vendimit nr.261/2 të ish KLD-së.). Nga këto 12 çështje, 8 prej tyre janë gjykuar jashtë afatit ligjor dhe 4 çështje brenda këtij afati.

Nga 8 çështjet e mësipërme ne do zbresim 3 çështje, pasi nga verifikimi i të dhënave statistikore ka rezultuar se :

Referuar tabelës së mësipërme për çështjet me numrin rendor 75 çështja është regjistruar me date 26.06.2019 dhe shortuar gjyqtares me date 05.07.2019 (9 ditë pasi është regjistruar) dhe date vendimmarrjes për këtë çështje është 25.07.2019 d.m.th. 20 ditë nga momenti i shortimit të çështje. Po në këtë tabelë për çështjen me nr. rendor 83, rezulton datë regjistrimi 26.07.2019 dhe shorti me date 03.09.2019, vendimmarrja me date 09.09.2019, dhe afati i përfundimit të gjykimit sipas të dhënave rezulton 45 dite, por nëse zbresim muajin gusht që llogarisim 35 ditë ose një muaj e 7 ditë kalendarike do shohim që kjo çështje është përfunduar brenda 10 ditëve d.m.th. brenda afatit ligjor prej 20 ditëve. Sa i përket çështjes së renditur me nr. rendor 88 është regjistruar me datë 20.09.2019 dhe shortuar gjyqtares me datë 24.09.2019 (4 ditë pasi është regjistruar) dhe datë e vendimmarrjes për këtë çështje është 16.10.2019, na rezulton se jemi vetëm 2 ditë tej afatit ligjor të parashikuar çka e bën të papërfillshme këtë tejkalim prej vetëm dy ditësh nëse zbresim pikërisht ditët që çështja ka pritur të shortohet tek gjyqtarja subjekt vlerësimi.

- Në tabelën me nr.2 të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*civile pa palë kundërshtare*”, rezulton se janë gjykuar 10 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor (çështjet me objekt marrje mase të përkohshme apo kërkesë me objekt kundërshtim veprimi përmbarimor), nga të cilat 5 janë gjykuar jashtë afatit ligjor dhe 5 brenda afatit ligjor.

Nga tabela me nr.2 ne do përjashtojmë vetëm 1 çështje nga 5 çështje që janë gjykuar jashtë afatit ligjor, sepse çështja me numër rendor 50 është regjistruar me date 22.05.2019 dhe shortuar gjyqtares me date 27.05.2019 (5 ditë pasi është regjistruar) dhe datë e vendimmarrjes për këtë çështje është 29.05.2019 , afati i gjykimit i përlllogaritur nga tabela rezulton 7 ditë ndërkohe që nëse zbresim pikërisht ditët (5 ditë) që çështja ka pritur të shortohet tek gjyqtarja subjekt vlerësimi atëherë rezulton se çështja është gjykuar brenda 2 ditëve çka do të thotë brenda afatit ligjor prej 5 ditësh që parashikon ligji.

- Në tabelën me nr.6 të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*tregtare pa palë kundërshtare*”, rezulton se janë gjykuar 130 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor (kryesisht çështjet me objekt regjistrim/depozitim aktesh, për të cilat ligji parashikon afat 15 ditor për shqyrtimin e tyre), nga të cilat 93 janë gjykuar jashtë afatit ligjor dhe 37 brenda afatit ligjor.

Nga tabela me nr.6 do përjashtojmë vetëm 13 çështje nga 93 çështje që janë gjykuar jashtë afatit ligjor, pasi rezulton se : Çështja me numër rendor 10 është regjistruar me date 20.12.2018 dhe shortuar gjyqtares me date 21.12.2018 dhe date vendimmarrjes për këtë

çështje është 07.01.2019, afati i gjykimit i përlllogaritur nga tabela rezulton 18 dite ndërkohe qe nëse zbresim pikërisht ditët 3 dite, datën 25 dhjetor dhe 1, 2 janar qe janë ditë pushimi festa zyrtarë atëherë rezulton se çështja është gjykuar brenda 15 ditëve çka do të thotë brenda afatit ligjor prej 15 ditësh qe parashikon ligji për çështjet te kësaj natyre. Çështja me numër rendor 35, 37,39, 48, 95 afati i gjykimit i përlllogaritur nga tabela rezulton 16-17 ditë çka do të thotë se tejkalimi me 1 apo 2 ditë tej afatit të parashikuar është e papërfillshme nëse kemi parasysh ngarkesën e gjyqtarës me 133 çështje të tilla në një vit. Tek çështja me numrin rendor 71 çështja është shortuar 4 dite pas regjistrimit dhe është përfunduar brenda 15 ditëve pasi afati për shqyrtimin e saj ka zgjatur 15 ditë duke zbritur 4 ditët që çështja ka pritur të shorohet tek gjyqtarja. Çështjet me numër rendor 101, 102, 103,105, 116, 119 janë shortuar 4 deri ne 8 dite apo 16 dite siç është rasti i çështjes me numrin rendor 120, pasi janë regjistruar dhe tejkalimi i afatit është 1 deri ne 2 dite përtej afatit te parashikuar ligjore çka do të thotë se kemi të bëjmë me një tejkalim te papërfillshëm, ose jemi brenda afatit ligjore siç është rasti i çështjes se sipërcituar renditur ne numrin rendor 120.

Në total rezulton se gjyqtarja për vitin 2019 sipas statistikave ka gjykuar 152 çështje, për të cilat ligji parashikon afat ligjor (nga të cilat 89 prej tyre janë gjykuar jashtë afatit ligjor) dhe 222 çështje me afat standard minimal.

Përfundimisht si rezultat i verifikimit të dhënave statistikore për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, duke zbritur çështjet për te cilat vonesa nuk ka qënë përgjegjësi e gjyqtarës pasi një pjesë e konsideruar e çështjeve janë shortuar shume ditë pas datës se regjistrimit, dite te varionin nga 4-8 apo 16 ditë pasi çështjet ishin të regjistruar rezulton se gjyqtarja subjekt vlerësimi, ka gjykuar në total 627 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 374 çështje janë shqyrtuar jashtë afatit ligjor.

Sa më sipër, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (gjithsej 374 çështje), me numrin e çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat ligjor (627 çështje), gjyqtarja Alma Kodraliu rezulton që të ketë gjykuar 59.6 % të çështjeve me afat ligjor jashtë këtij afati nga 70.3 % qe referon raporti analitik.

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: *kompleksiteti i çështjeve këtu vlen të përmendet se gjyqtarja ka gjykuar çështje te natyres civile dhe tregtare dy katergori që kanë një impenjim dhe kane një ngarkese të madhe sa i perket angazhimit ne kryerjen e procedurave ne afate, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së saj, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës.*

Vetë fakti i të qenurit gjyqtare pranë Gjykatës së Shkalles së Parë Tiranë nënkupton një ngarkesë shumë me të madhe çështjesh të rregjistruara në këtë gjykatë dhe në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja Alma Kodraliu, ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi (01.01.2017-31.12.2019), 1351 çështje, nga të cilat 627 çështje parashikojnë afat ligjore gjykimi. Pra, 46.4% të numrit total të çështjeve kanë qënë me afat ligjor, përqindje tepër e lartë duke e ngarkuar shumë gjyqtaren me çështje që kërkonin shpejtësi gjykimi. Gjithashtu, rezulton se nga numri i përgjithshëm i çështjeve, 616 çështje janë me palë kundërshtarë.

Referuar standardit sasior në fuqi, gjyqtari duhet të përfundonte jo më pak se 120 çështje me palë kundërshtare në vit, pra 360 çështje në tre vjet. Gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja ka përfunduar 616 me palë kundërshtare, ose 205.3 çështje në vit nga 120 çështje që është e përcaktuar në Vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010 të ish-KLD-së, duke e kaluar standardin sasior me 256 çështje ose 70.8 %.

Përfundimisht sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të lartë për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (1 deri në 2 ditë) si dhe zbritet koha gjatë se cilës gjyqtari ka kryer lejen vjetore, atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 374 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (374 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (627 çështje), rezulton të jetë 59.6 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor, përqindje që sipas Metodologjisë vlerësohet me 3 pikë, por për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: ngarkesën e gjyqtares si relatore (në total për tre vite ka gjykuar 1351 çështje, nga të cilat 46.4 % apo 627 çështje janë me afat ligjore), duke gjykuar mesatarisht rreth 450 çështje në vit nga të cilat 209 janë me afat ligjore, faktin se ajo e ka tejkaluar standardin sasior mesatar me 70.8 % dhe aspektet që lidhen me kushtet e punës, konkretisht kohën që gjyqtarja kalon në zhvillimin e seancave, seanca të shumta në numer gjatë një dite pune, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “11-20 %”, duhet pikëzuar me 12 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “11-20 %”, duke e pikëzuar me 12 pikë.*

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore të integruara për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej: 724 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate standarde gjykimi, nga të cilat 238 çështje janë shqyrtuar jashtë afatit standard minimal dhe 486 janë shqyrtuar brenda këtij afati. Sa më sipër, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit standard minimal (gjithsej 238 çështje), me numrin e çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat (724 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 32.87 % të çështjeve jashtë afatit standard minimal. Në këto 238³² çështje (76 çështje në vitin 2017, 73 çështje në vitin 2018 dhe 89 çështje në vitin 2019), të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Tregtare me palë kundërshtare”, “Tregtare pa palë kundërshtare”, “Marrëdhënie pune”, për të cilat vendimi nr.261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë:

- jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile me palë kundërshtare ;
- jo më tej se 2 muaj për çështjet civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj për çështjet tregtare pa palë kundërshtare

³² Pa përfshirë këtu çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.

- jo më tej se 6 muaj për çështjet tregtare me palë kundërshtarë
- jo më tej se 6 muaj për çështjet me objekt marrëdhënie pune;

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 724 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 238 prej tyre ose 32.87% janë gjykuar jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit dhe të pasqyruara në raportin analitik, ka shpjeguar shkaqet e mbarimit të afateve orientuese standard minimal kohor, duke vlerësuar në mënyrë të përmbledhur vonesat kanë ardhur për shkak të volumi i punës dhe kompleksiteti i çështjeve janë faktorë kyç që ndikojnë në respektimin e afateve orientuese. Sipas gjyqtarës në lidhje me këtë tregues, duhen pasur parasysh edhe faktorë të tjerë të cilët kushtëzojnë përfundimin e çështjeve në afatet e caktuara. Konkretisht:

-“Numri i tepër i madh i çështjeve të shortuara, pasja parasysh se në shumë raste çështjet janë rishortuar pas përjashtimit të gjyqtarëve të tjerë.

- Informaliteti në sistemin e adresave dhe problemet e njohura tashmë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shërbimin postar. Në shumë raste që në një seancë njoftojë pala, ndërsa në seancën tjetër nuk njoftojë për shkak adrese të pasaktë, nga i njëjti postier, raste për të cilat janë bërë dhe ankesa të drejtpërdrejta me shkrim për këtë fakt, duke u bashkëngjitur dhe konfirmimet e fletëhirrjeve. Po kështu, duhen pasur parasysh problematikat që sjell njoftimi kur ka shumë palë ndërgjyqëse. Nga ana tjetër edhe në rastet e kërkesave për ndryshim objekti apo shkak ligjor në mënyrë të pashmangshme sillnin shtyrjen e seancës. Nga ana tjetër, në rast mos njoftimi të palës në adresën e dhënë, me qëllim procedimin me shpallje kam kërkuar vetë në zyrën e gjendjes civile adresën zyrtare të palës për kryerjen e njoftimit me shpallje.

-Sjellja e palëve, e në këtë drejtim, në vlerësimin e gjyqtarit duhet mbajtur parasysh edhe fakti se çfarë masash ka marrë ai, që të mos lejojë palët që të abuzojnë me të drejtat që u njeh ligji. Në këtë drejtim përmend kërkesat për shtyrje seance (përmes raporteve mjekësore, etj); kërkimin e kohës për t'u njohur me aktet; nevoja për kryerjen e akteve të ekspertimit dhe po kështu faktit që palët që ngarkoheshin me shpenzimet gjyqësore nuk i parapaguanin ato sipas ligjit dhe si rrjedhojë, eksperti nuk kryente aktin e ekspertimit; mospërgjigja në kohë e institucioneve shtetërore (për të cilat në shumë raste jam detyruar të marr vendim për dënimin me gjobë për mosbindje ndaj urdhrave të gjykatës).

-Kompleksiteti i çështjeve, për të cilat Gjykata e Tiranës është e njohur për çështjet me shumë palë, komplekse dhe të natyrave të ndryshme.

-Ndryshimeve ligjore me Ligjin 38, dt. 30.03.2017, puna e gjyqtarit në zyrë, në dhomë këshillimi ka marrë një tjetër dimension. Konkretisht, në shumë raste me njohjen me padinë dhe me provat, është marrë vendim për plotësim të të metave të padisë, me qëllim që palës së paditur t'i njoftojë një padi e rregullt dhe ajo të ishte në gjendje të realizonte mbrojtjen e saj. Sipas subjektit vlerësues vlerësimi i gjyqtarit thjesht me një logjikë matematikore, edhe pse i rëndësishëm, nuk mjafton pasi është shumë e rëndësishme që të mbahen parasysh elementet e përmendura më sipër (të cilët synojnë dhënien e një tabloje, por nuk janë shterues) dhe në vlerësimin e gjyqtarit të konsiderohen, së pari, masat e marra nga gjyqtari në zhvillimin e seancave efektive dhe së dyti, moslejimin e palëve që të abuzojnë me të drejtat e njohura nga ligji.”

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 238 çështjet e shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, rezulton se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e

lejes vjetore të kryer nga gjyqtari (*muaj gusht i vitit 2017, vitit 2018, dhe vitit 2019*). Nëse në përlllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periudha kur gjyqtari ka qenë me leje vjetore, atëherë disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor. Konkretisht:

- çështja me numër rendor 14 (*Tabela 1-, viti 2017*), i është caktuar gjyqtarit me short në datën 12.07.2016 dhe ka përfunduar në datën 01.02.2017, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 167 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 17 (*Tabela 1-, viti 2017*), i është caktuar gjyqtarit me short në datën 15.07.2016 dhe ka përfunduar në datën 20.01.2017, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 154 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 29 (*Tabela 1-, viti 2018*), i është caktuar gjyqtarit me short në datën 27.06.2017 dhe ka përfunduar në datën 01.02.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 184 ditë, pra vetëm me 4 dite ne tejkalim të standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 31 (*Tabela 1-, viti 2018*), i është caktuar gjyqtarit me short në datën 12.07.2017 dhe ka përfunduar në datën 01.02.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 169 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 33 (*Tabela 1-, viti 2018*), i është caktuar gjyqtarit me short në datën 20.07.2017 dhe ka përfunduar në datën 05.02.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 165 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 100 (*Tabela 1-, viti 2018*), i është caktuar gjyqtarit me short në datën 30.03.2018 dhe ka përfunduar në datën 12.10.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 161 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 104 (*Tabela 1-, viti 2018*), i është caktuar gjyqtarit me short në datën 06.04.2018 dhe ka përfunduar në datën 11.10.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 149 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 112, 113, 116,127 (*Tabela 1-, viti 2018*), i janë caktuar gjyqtares me short përkatësisht në datat 11.05.2018, 14.05.2018, 17.05.2018 dhe 05.06.2018 dhe kane përfunduar në datën 27.11.2018, datën 23.11.2018, 16.11.2018 dhe 05.12.2018 duke hequr periudhën e lejes vjetore, këto çështje do të kishin përfunduar për 165 ditë, 158 dite, dhe dy te fundit me 148 ditë tjetra, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 22 (*Tabela 2, viti 2018*), i është caktuar gjyqtarit me short në datën në datën 23.07.2018 dhe ka përfunduar në datën 26.09.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 34 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 274 (*Tabela 2, viti 2017*), i është caktuar gjyqtarit me short në datën 08.06.2017 dhe ka përfunduar në datën 05.09.2017, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 59 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 22 (*Tabela 5, viti 2018*), i është caktuar gjyqtarit me short në datën në datën 04.06.2018 dhe ka përfunduar në datën 13.12.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 157 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve tregtare me palë kundërshtare;

- çështja me numër rendor 4 (*Tabela 5, viti 2019*), i është caktuar gjyqtarit me short në datën në datën 29.06.2018 dhe ka përfunduar në datën 17.01.2019, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 167 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve tregtare me palë kundërshtare;
- çështja me numër rendor 47,48,51,55 (*Tabela 5, viti 2019*), i janë caktuar gjyqtarës me short në datat respektive 25.03.2018, 18.04.2019, 25.04.2019 dhe 23.05.2019 dhe kanë përfunduar në datat 19.10.2019, 11.10.2019, 24.10.2019 dhe 18.11.2019, duke hequr periudhën e lejes vjetore, këto çështje do të kishin përfunduar për 163 dite, 172 dite, 147 ditë, 167 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve tregtare me palë kundërshtare
- çështja me numër rendor 18 (*Tabela 7, viti 2017*), i është caktuar gjyqtarit me short në datën në datën 08.06.2017 dhe ka përfunduar në datën 12.12.2017, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 152 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve me objekt marrëdhënie pune;
- çështja me numër rendor 19 (*Tabela 7, viti 2017*), i është caktuar gjyqtarës me short në datën në datën 13.03.2018 dhe ka përfunduar në datën 24.09.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 160 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve me objekt marrëdhënie pune;
- çështja me numër rendor 5 (*Tabela 7, viti 2018*), i është caktuar gjyqtarës me short në datën në datën 09.11.2017 dhe ka përfunduar në datën 20.02.2018, duke tejkaluar me vetëm me 1 ditë, standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve me objekt marrëdhënie pune,
- çështja me numër rendor 22 (*Tabela 7, viti 2018*), i është caktuar gjyqtarës me short në datën në datën 05.04.2018 dhe ka përfunduar në datën 01.11.2018, duke hequr periudhën e lejes vjetore, kjo çështje do të kishte përfunduar për 175 ditë, pra brenda standardit minimal kohor për gjykimin e çështjeve me objekt marrëdhënie pune

Nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, do të përjashtoheshin çështjet e analizuara më sipër, atëherë do të rezultonte se nga 724 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 215 prej tyre ose 29.6% janë gjykuar jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numrit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, në raport me numrin total të çështjeve të gjykuara, kohës relativisht të shkurtër të tejkalimit të standardit minimal kohor në disa e çështjeve të analizuara (*tejkalime nga 1 ditë,³³ 3 ditë³⁴*) sipas të dhënave statistikore, po kështu duke marrë në konsideratë fakti se gjyqtarja ka gjykuar një numër të konsiderueshëm çështjesh të përfunduara në tre vite prej 1351 çështje në total, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi sesa ai që i përket përqindjes së çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pra, në nivelin 0-10%, duke e pikëzuar me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet në nivelin “0-10%”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

³³ Çështja me nr. Rendor 5, Tabela 7, viti 2018.

³⁴ Çështja me nr. Rendor 30, Tabela 2, viti 2018.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr.261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e kategorive të çështjeve. Konkretisht,

- (i) Në lidhje me 388 çështje civile të kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, (2017-2019) koha mesatare rezulton të jetë 163.9 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së prej 6 (gjashtë) muajsh.
- (ii) Në lidhje me 136 çështje civile të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, (2017-2019) koha mesatare rezulton të jetë 70.9 ditë, pra **më e gjatë** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muajsh sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së.
- (iii) Në lidhje me 115 çështje të kategorisë “*tregtare me palë kundërshtare*”, (2017-2019) koha mesatare rezulton të jetë 122.9 ditë, pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 6 (gjashtë) muaj sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së.
- (iv) Në lidhje me 14 çështje të kategorisë “*tregtare pa palë kundërshtare*”, (2017-2019) koha mesatare rezulton të jetë 56.3 ditë, pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muaj sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së.
- (v) Në lidhje me 71 çështje civile të kategorisë “*marrëdhënie pune*”, (2017-2019) koha mesatare rezulton të jetë 123.4 ditë, pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 6 (gjashtë) muaj sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së.

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës.³⁵ Referuar metodologjisë, duke qenë se nga 5 kategori çështjesh, vetëm për 1 prej tyre koha mesatare tejkalon standardin minimal kohor, gjyqtari duhet të pikëzohej me 4 pikë, por vlerësuesi merr parasysh në pikëzim situatën konkrete, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Nga analiza e të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej vetëm 1 nga 5 kategoritë e çështjeve, duke u tejkaluar koha mesatare përkatësisht 10.9 ditë për kategorinë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”.

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është dukshëm më e shkurtër se ky afat për 4 nga 5 kategoritë e çështjeve. Koha mesatare është më e gjatë se standardi vetëm për një nga kategoritë e çështjeve. Gjithashtu duke marrë në konsideratë fakti se gjyqtarja ka një ngarkesë

³⁵ Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se: “... Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal”.

të madhe të çështjeve të shqyrtuara, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë, duke e pikëzuar me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje duhet të konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1351 çështje), me numrin e çështjeve të caktuara (1517 çështje), është 89.05%.

Sipas pikës 3 shkronja “e”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, i dhomës civile si relator i seksionit të përgjithshme (duke qenë se gjyqtarja ka gjykuar çështje civile dhe tregtare), duhet të jetë në cilësinë e relatorit jo më pak se 120 gjykime çështjesh civile me palë kundërshtare.

Në vitin 2017 gjyqtarës subjekt vlerësimi rezultojnë se i janë caktuar 557 çështje. Referuar të dhënave statistikore rezultojnë se për vitin 2017 gjyqtarja ka përfunduar 564 çështje. Nga të cilat 199 çështje me palë kundërshtare **duke e tejkaluar me 79 çështje ose 65.8 % standardin minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.**

Në vitin 2018 gjyqtarës subjekt vlerësimi rezultojnë se i janë caktuar 438 çështje. Referuar të dhënave statistikore rezultojnë se për vitin 2018 gjyqtarja ka përfunduar 418 çështje. Nga të cilat 235 çështje me palë kundërshtare **duke e tejkaluar me 115 çështje ose 95.8 % standardin minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.**

Në vitin 2019 gjyqtarës subjekt vlerësimi rezultojnë se i janë caktuar 522 çështje. Referuar të dhënave statistikore rezultojnë se për vitin 2019 gjyqtarja ka përfunduar 369 çështje. Nga të cilat 182 çështje me palë kundërshtare **duke e tejkaluar me 62 çështje ose 51.6 % standardin minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli**

Në total për të tre vitet e plota të punës, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja ka përfunduar 616 çështje me palë kundërshtare, **duke tejkaluar me 256 çështje ose me rreth 71.1 % standardin sasior në fuqi prej 120 çështje në vit.**

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe zv.kryetari e kanë vlerësuar treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” në shkallë shumë të lartë (mbi 99%). Gjyqtarja parashtron si shkaqe që kanë ndikuar në rendimentin e përfundimit të çështjeve, se duke qenë pjesë e seksionit tregtar, mendoj se duhet marrë parasysh fakti që nuk ngarkoheshim me urdhra (për një periudhë kohore)të cilët rrisnin numrin total të çështjeve. Po kështu, edhe kërkesat që lidhen me organizatat jofitimprurëse, pavarësisht se janë kërkesa, mund të konsiderohen si çështje themeli, për shkak të problematikës dhe angazhimit që kërkojnë nga ana e gjyqtarit. Po kështu, duhet mbajtur parasysh edhe kryerja e veprimeve paraprake, të cilat zënë një kohë të konsiderueshme të gjyqtarit. Ndërkaq, duhet pasur parasysh se shumë nga paditë një ndër kërkimet e tyre kanë edhe marrjen e masës së

sigurimit. Si veprimet paraprakë ashtu edhe vendimet e ndërmjetme që zbardh gjykata janë veprimtari e gjyqtarit që nuk reflektohet, megjithëse merr kohë të konsiderueshme gjykimi.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se : “Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.

Sa me sipër duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 89.1 %, por ndërkohë rezulton se (i) ajo ka tejkaluar standardin sasior për çështjet e themelit të përfunduara me 71.1 %, (ii) ka përfunduar një numër të konsiderueshëm çështjesh pa palë kundërshtare 735 çështje si dhe rendimenti 89.1 % pikëzohet me 6 pikë, vlerësoj se, në analizë logjike të dhënave statistikore, duke marrë në konsideratë përqindjen e çështjeve të shqyrtuar tej standardit minimal sasior 71.1 % dhe ngarkesën totale në punë, gjyqtarja duhet të vlerësohet dhe pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues pasi duket qartë që shkaqet që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtarës lidhen me ngarkesën e punës gjatë periudhës së vlerësimit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” është “+99%”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

1. Për çështje të kategorisë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 17.5 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
2. Për çështje të kategorisë “civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 9.4 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
3. Për çështje të kategorisë “tregtare me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 26.6 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
4. Për çështje të kategorisë “tregtare pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 7.03 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile
5. Për çështje të kategorisë “marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsytimit është 17.9 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
6. Për çështje të kategorisë “hetime paraprake”, me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi apo zëvendësim mase sigurimi koha mesatare e arsytimit është 15.5 ditë,

pra **më e gjatë** se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 249 dhe 260 i K. Pr. Penale.

7. Për çështje të kategorisë *“hetime paraprake”*, me objekt rivlerësim mase sigurimi koha mesatare e arsytimit është 40 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 244/1 dhe 248/2 i K. Pr. Penale.

Sa më lart rezulton se nga 7 kategoritë e çështjeve vetëm për 3 kategori koha mesatare e arsytimit është më e gjatë se afati procedural i parashikuar nga ligji dhe gjyqtarja për këtë tregues të vlerësohet sipas Metodologjisë me 12 pikë, *“Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për shumicën e kategorive të çështjeve”*, por sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës si angazhimi i gjyqtarës në gjykime, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Në vijim të arsytimit të mesiperm, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja Alma Kodraliu ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi (01.01.2017-31.12.2019), 1351 çështje, nga të cilat 627 çështje parashikojnë afat ligjor gjykimi. Pra, 46.4% të numrit total të çështjeve kanë qënë me afat ligjor, përqindje tepër e lartë duke e ngarkuar shumë gjyqtaren me çështje që kërkonin shpejtësi gjykimi. Gjithashtu, rezulton se nga numri i përgjithshëm i çështjeve, 616 çështje janë me palë kundërshtare. Referuar standardit sasior në fuqi, gjyqtarja duhet të përfundonte jo më pak se 120 çështje me palë kundërshtare në vit, pra 360 çështje në tre vjet. Në rastin konkret, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja ka përfunduar 616 me palë kundërshtare, ose 205.3 çështje në vit nga 120 çështje që është e përcaktuar në Vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010 të ish-KLD-së, duke e kaluar standardin sasior me 256 çështje ose 70.8 %.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe zv/kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtarja ka parashtruar se *“...Volumi i punës lidhet pazgjidhshmërisht me kohën e arsytimit të vendimeve. Ndërkaq seksioni tregtar ka një numër më të lartë çështjesh se seksionet e tjera, pasi ky seksion ngarkohet me të gjitha çështjet tregëtare, e po kështu merr edhe çështje civile, ndërkohë që çështjet tregtare, përgjithësisht kërkojnë angazhim relativisht më të madh për shkak të problematikës së çështjeve të këtij seksioni. Po kështu edhe veprimet paraprake dhe arsytimi i vendimeve të ndërmjetme (masa sigurimi padie, pezullim veprimesh përmbarimore, mos kompetenca, etj), zënë një kohë të konsiderueshme të gjyqtarit. Pasur parasysh edhe kohën e zhvillimit të seancave gjyqësore, koha që ngelet në dispozicion të gjyqtarit për arsytimin e vendimeve është minimale. Nga ana tjetër, arsytimi i vendimeve gjyqësore pasqyrojnë veprimtarinë e gjyqtarit përgjatë gjithë procesit gjyqësor dhe është një akt i cili ngelet dhe kërkon vëmendje dhe kohë. Megjithatë, theksoj se jam munduar që arsytimi i vendimeve të kryhet në kohë, pavarësisht ndonjë rasti, të cilin edhe e kam sqaruar në lidhje me shkaqet e vonës në relacionet mujore që dërgoheshin në KLGJ, të cilat në të shumtën e rasteve nuk kanë qënë të lidhura me veprimtarinë time si gjyqtare, por me vonesa apo mënyrë jo e duhur e organizimit të punës nga administrata gjyqësore (ngarkesa e sekretarit gjyqësor, i cili nuk arrinte të lidhte fashikullin gjyqësor dhe ta dorëzonte, për shkak se koha prej tetë orësh nuk mjaftonte për të përfunduar punën dhe qëndrimi jashtë orarit zyrtar ka qënë i*

pamundur për të. Po kështu ka pasur raste që kryesekretari kthente fashikullin për ndonjë nënshkrim të munguar dhe e shënonte datë dorëzimi datën kur dosja rikthehej në kryesekretari, etj.). Të gjitha këto rrethana mendoj se duhen mbajtur parasysh në lidhje me vlerësimin sa i takon shpejtësisë së arsyetimit të vendimeve.”

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar duhet të klasifikohet si “*Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve*” dhe gjyqtarja duke të pikëzohet me 15 pikë për këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues duhet të vlerësohet “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

Në tabelat me të dhëna statistikore të dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mungojnë të dhëna lidhur me numrin e seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe në mungesë të kësaj vlerësimi bëhet duke iu referuar 19 (nëntëmbëdhjetë)³⁶ nga 21 (njëzet e një) çështjet e përzgjedhura me short.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

Referuar të dhënave statistikore³⁷, rezulton se nuk është gjeneruar numri i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe në mungesë të saj do t’i referohemi **në total** 19 (nëntëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short, për të cilat rezulton se numri mesatar është ***3.7 seanca gjyqësore*** (duke përjashtuar seancat përgatitore dhe çështjet pa palë kundërshtare³⁸).

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për

³⁶ Duke përjashtuar çështjen me nr. 11321 akti , datë 22.11.2017, nr. vendimi 537/1,date 09.10.2019 për shkak se i përkasin kategorisë së çështjeve pa palë kundërshtare.

³⁷ Sipas metodologjisë së pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, në lidhje me këtë tregues është parashikuar:” *Treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikave mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjyqësorëve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.*” Duke iu referuar statistikave, të përcjella nga Gjykata e Shkallës së Parë Tirane, rezulton se nuk ka të dhëna për numrin e seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh pasi aty janë përfshirë edhe seancat përgatitore, ndaj do të merret si burim vlerësimi për këtë tregues çështjet e përzgjedhura me short.

³⁸ Sipas metodologjisë së pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, në lidhje me këtë treguesin e numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, është parashikuar: ” *Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh , duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse.*”

palët që u drejtohen, përgjithësisht nuk konstatohet mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtari për çdo çështje ka disponuar me urdhër për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes, duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kriterëve të parashikuara në K.Pr.Civile.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme, të tilla si: *mosnjoftimi i palëve rregullisht, ndryshimi i adresës së të paditurit, mosformim i trupit gjykues (pamundësia shëndetësore gjyqtare, pjesëmarrja e gjyqtare në seminare trajnuese apo konference); realizimin e aktit të ekspertimit; ose mosrealizimi në kohë i aktit të ekspertimit, njohjen me aktin e ekspertimit; shtimi i ndërgjyqësisë; kërkesat për shtyrje të palëve; saktësim i objektit të padisë, paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim, apo për të shpallur vendimin të arsyetuar etj.*

Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtare së çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

Gjyqtarja subjekt vlerësimi ka bërë të pamundurën për të marrë masa që të mos ketë seanca gjyqësore joproduktive siç është rasti i çështjes që i përket vendimit nr.10016 date 27.11.2017 me qëllim marrjen e masave për shmangien e seancave joproduktive rezulton se gjyqtarja i është drejtuar me shkresë Komisarariatit përkatës me qëllim për të bërë të mundur mbështetjen në kryerje veprimeve duke shoqëruar ekspertin për të kryer matjet në funksion të kryerjes së aktit të ekspertimit. Gjithashtu gjyqtarja ka disponuar me vendim për t'ju drejtuar njëkohësisht edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Komisarariatit përkatës për të marrë gjeneralitetet e sakta të personit, i cili posedon pronën objekt gjykimi (*fakt i ri i nxjerre nga aktit të ekspertimit*), çka tregon marrjen e masave konkrete nga gjyqtarja me qëllim shmangien e seancave joproduktive.

Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarit të çështjes dhe siç rezulton nga sa me sipër gjyqtarja ka bërë të pamundurën për të marrë masat për aq sa ka qenë e mundur që të shmangte seancat joproduktive dhe zgjatjen në kohë të gjykimit, por kompleksiteti i çështjeve të gjykuara nga gjyqtarja dhe informaliteti i sistemit adresave të palëve një fakt i njohur botërisht dhe problematik për sistemin gjyqësor dhe jo vetëm, ka bërë që në disa raste të ishte e pamundur shmangia e seancave joproduktive. Ajo çfarë ka ndikuar në mesataren e seancave gjyqësore është pikërisht çështja me nr Rregj. Them. 8726 datë rregjistrimi 21.04.2017 përfunduar me vendimin nr. 2476 date 16.03.2018 në të cilën kemi të bëjmë me një padi me shume pale në të cilën problematika ka qenë pikërisht njoftimi i tyre për shkak të adresave të pasakta ose zëvendësimi i mbrojtësve.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 3.7 seanca duke e tejkaluar me 0.7, tejkallim i cili vlerësohet i papërfillshëm duke marrë në konsideratë problematikat e përmendura mesiper, prandaj për gjyqtaren subjekt vlerësimi, shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet në një nivel më të lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive” aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se përgjithësisht gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht, në çështjet civile gjyqtarja është shprehur me vendim, si për njoftimin e akteve dhe kërkesës padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, pas ezaurimit të seancës përgatitore edhe kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (neni 158/ç i K.Pr.Civile).

Gjatë gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të paditurve, shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit shkresorë me institucionet e tjera, etj*).

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes. Në dosjet e vëzhguara, përgjithësisht, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, por ndeshen disa vonesa të vogla të papërfillshme apo 7-8 min. dhe vetëm një rast me 28 min. me vonësë, shkaqet të relatuar nga gjyqtarja në seance, që lidhen me organizimin dhe përgatitjen e sallës për gjykim ose të diktuar nga kohëzgjatja e seancës pararendëse.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, janë mbajtur me regjistrim audio, si dhe janë dokumentuar me shkrim nga sekretarja gjyqësor. Megjithatë, duhet të theksohet se në asnjë rast fillimi me vonesë nuk është bërë shkak për mos zhvillimin e seancës gjyqësore.

Gjyqtarja, subjekt vlerësimi pothuajse në çdo gjykim u ka sjellë në vëmendje palëve të drejtën e për ta zgjidhur çështjen me ndërmjetësim.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe zv/kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtarja ka parashtruar se “...Sa i takon vënies në lëvizje të

dosjeve nuk kam pasur vonesa, qoftë dhe në çështjet në të cilat kishte kërkesa për caktim mase sigurimi, i kam marrë në shqyrtim brenda afatit ligjor, megjithë vështirësitë për shkak të kalendarit të ngarkuar. Sa i takon veprimeve përgatitore, vlerësoj shumë të rëndësishme veprimtarinë paraprake të gjyqtarit në dhomë këshillimi. Një numër i konsiderueshëm çështjesh të reja që shortohen kanë të meta në padi (rreth një në tre çështje), çfarë dikton nevojën e lënies kohë për plotësimin e të metave me anë të një vendimi. Nuk caktoj seancë përgatitore, por dërgoj vendim sepse përpara se të thërras palën e paditur, vlerësoj se padia duhet të jetë e ngritur rregullisht dhe pala e paditur ta ketë të qartë çfarë kërkohet dhe arsyen pse është thirrur në gjykim. Me plotësimin e të metave të padisë përpara afatit të lënë, nuk pres përfundimin e tij, por njoftoj menjëherë aktet palëve të paditura. Kur është e nevojshme marrja e provës me ekspert e caktoj marrjen si provë që në urdhërin e veprimeve paraprake dhe caktoj edhe ekspertin. Në momentin që lë seancën e veprimeve përgatitore, u njoftoj palëve edhe emrin e ekspertit së bashku me shënimin që në rast kundërshtimesh t`i paraqesin të paktën tre ditë para seance. Theksoj se të gjitha seancat përgatitore dhe gjyqësore (përvec ndonjë rasti kur nuk gjendet sallë e lirë) i kryej në sallë dhe kujdesem për fillimin e seancës në afat, madje relatoj edhe filimin e seancës me pesë minuta vonesë dhe arsyen e vonesës. Arsyet e vonesave janë të lidhura kryesisht me vendndodhjen e sallave në raport me ambjentin ku qëndrojnë palët dhe sekretaria është e detyruar t`i thërrasë në kohë dhe jo më parë. Në veprimet përgatitore, diskutohen çështjet e rëndësishme për procesin, si legjitimitet formal, kompetencë, orientohen palët në çështjet e rëndësishme për t`u diskutuar dhe nëse janë të nevojshme për zgjidhjen e çështjes, u caktoj sipas rastit palëve detyrë për paraqitjen e provave të caktuara. Në këtë drejtim, gjykata përcaktohen provat që do merren në gjykim, ndër to edhe prova me ekspert, ku ky i fundit betohet dhe merr detyrat. Po kështu, me shumë rëndësi e konsideroj zgjidhjen e çështjes me marrëveshje. Konstatoj që për palët ndërmjetësimi nuk konsiderohet një mënyrë efektive e zgjidhjes së marrëdhënieve të tyre, por ndërkohë, gjatë seancave, aty ku konstatoj se palët nuk janë shumë të acaruar me njëra tjetrën, disa minuta i kushtoj sensibilitetit të palëve për zgjidhjen e çështjes me marrëveshje ndërmjet tyre. Një veprim të tillë, e kryej edhe gjatë gjykimit, deri në përfundim të tij, sa herë që konstatoj që njëra palë është e hapur për diskutime me palën tjetër. Madje në shumë çështje kam lënë kohë dhe kam shtyrë disa seanca vetëm për këtë shkak pasi palët kanë pretenduar se janë duke diskutuar zgjidhjen e çështjes me marrëveshje. Ka pasur disa raste që nuk ka funksionuar, por në shumicën e rasteve palët kanë rënë dakort. Më tej, çështja kalohet në seancë gjyqësore, duke i lënë ekspertit detyrë për depozitimin e aktit në një datë të caktuar e po kështu dhe palët kanë një periudhë të caktuar kohore për të tërhequr aktin e ekspertimit dhe në seancë gjyqësore, diskutohet akti i ekspertimit. Nëse nuk ka pyetje shtesë për ekspertin apo pyetje sqaruese, të cilat kërkojnë kohë (dhe caktimin e një tjetër seance), mbyllet hetimi gjyqësor dhe u lihet kohë palëve sipas kërkesave të tyre për konkluzionet përfundimtare. Vë theksin se i kushtoj shumë rëndësi arsyesimit të vendimarrjes sa i takon vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë gjithmonë të arsyetuara. ”

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Sa me sipër vlerësoj se gjyqtarja për këtë tregues duhet të vlerësohet “shume e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “shume e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjes janë të renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj.

Në çështjet burim vlerësimi aktet renditen duke ndjekur logjikën e grupimit të tyre sipas kategorisë duke filluar aktet e shortit, kërkesë padinë, provat dhe aktet e përfaqësimit të palëve, aktet e ekspertimit të kryera gjatë gjykimit apo provat e marra nga të tretët, vendimet dhe aktet e komunikimit me palët gjatë veprimeve paraprake, përgatitore dhe urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore, së bashku me njoftimet, diskutimet përfundimtare me shkrim të palëve dhe vendimin gjyqësor përfundimtar. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*veprimet paraprake, njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

Në tërësi, rezulton se renditja akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (*kërkesëpatria, provat, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*), aktet e hartuara nga gjykata (*vendimi për kryerjen e veprimeve përgatitore, vendim për kalimin e çështjes në seancë përgatitore, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore përfundimtare*).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Nivelin i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
96	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarës u konstatuan këto të dhëna:

Referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresat me nr. 2270 prot., datë 11.05.2021, nr. 1907/2 prot., datë 05.10.2022, nr. 333/1 prot., datë 24.01.2023 dhe shkresës me nr. 1905/1 prot datë 04.07.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rezulton se konkretisht :

Për periudhën 01.01.2017 - 31.12.2019, për gjyqtaren Alma Kodraliu janë paraqitur 6 (gjashtë) ankesa dhe më konkretisht:

1. Ankuesë znj. Violeta Sillo, depozituar ankesa pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr.89/1 prot., datë 21.08.2017, e cila i është përcjellë për kompetencë ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë me nr.2519 prot., datë 23.08.2017. Kjo ankesë është regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1254 prot., datë 22.02.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 883 prot., datë 08.04.2022 ka disponuar “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasja znj. Violeta Sillo”.

2. Ankues z. Jalldiz Zhegu dhe Znj. Mahmudie Tugu, depozituar ankesa pranë ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë me nr.446 prot., datë 31.01.2018 dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr.361 prot., datë 29.01.2021. Pas verifikimit të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr . 2296/1 prot., datë 11.11.2022 ka disponuar “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së shtetasve Jalldiz Zhegu dhe Mahmudie Tugu ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarës Alma Kodraliu të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ”.
3. Ankues z. Nias Sillo, depozituar ankesa pranë ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë me nr. 2309 prot., datë 18.07.2017 dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1263 prot., datë 22.02.2021. Pas verifikimit të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 1113/1 prot., datë 24.03.2023 ka disponuar “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së ankesës së paraqitur nga shtetasi Nias Sillo”.
4. Ankues z. Adi Brojka, depozituar ankesa pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr.1901 prot., datë 02.04.2021. Pas shqyrtimit verifikimit të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr.1901/3 prot., datë 06.05.2021 ka disponuar “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi Adi Brojka”.
5. Ankuese znj. Arledia Shena, depozituar ankesa pranë ish Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.2729 prot., datë 15.03.2019 dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr.1146 prot., datë 16.06.2020. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr.1950/1 prot., datë 11.10.2022 ka disponuar “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasja Arledia Shena”.
6. Ankues Z. Feti Dema, depozituar ankesa pranë ish Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.11 prot., datë 03.01.2019 dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 764 prot., datë 01.06.2020. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 764 prot., datë 09.12.2020 ka disponuar “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi Feti Dema”.

Në tërësi nga sa u pasqyrua më sipër ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarës Alma Kodraliu në periudhën e vlerësimit, pasi janë verifikuar nga ILD, nuk rezultojnë të kenë elementë, të cilët mund të cenojnë etikën në punë të gjyqtarit pasi pretendimet e ankuesve nuk kanë qenë pretendime konkrete ose kanë qenë pretendime që lidhen me mënyrën e zbatimit të ligjit procedural apo zgjidhjen në themel të çështjes, e cila është objekt i kontrollit vetëm nëpërmjet mjeteve ligjore të ankimit nga gjykata më e lartë.

Sa i takon masave disiplinore, rezultojnë se për periudhën 01.01.2017- 31.12.2019, për gjyqtarën Alma Kodraliu, nuk është dhënë asnjë e tillë.

Nga aktet e trajtimit të ankesave të dërguara nga ILD nuk rezultojnë të dhëna të drejtpërdrejta apo të tërthorta të cilat mund të vlerësohen në drejtim të treguesve të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtarës Alma Kodraliu. Gjyqtarja dhe zv/kryetari e gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarës në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenoje etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, ndaj gjyqtares Alma Kodraliu nuk rezulton të jetë paraqitur ndonjë ankesë. Gjithashtu nga përmbajtja e ankesave ndaj gjyqtares subjekt vlerësimi dhe përfundimeve të arritura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në lidhje me to nuk rezulton të kenë elementë, të cilët mund të çenojnë integritetin e gjyqtares pasi pretendimet e ankuesve ose nuk kanë qenë pretendime konkrete ose kanë qenë pretendime që lidhen me mënyrën e zbatimit të ligjit procedural apo zgjidhjen në themel të çështjes, e cila është objekt i kontrollit vetëm nëpërmjet mjeteve ligjore të ankimit nga gjykata më e lartë. Nuk rezulton që ndaj gjyqtares, Alma Kodraliu gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar raportit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për gjyqtaren Alma Kodraliu, përcjellë pranë KLGJ-së me shkresën nr.2807/1 prot. datë 09.07.2021 rezulton se: *Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin numrin .9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin numrin .9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimi e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si dhe ligjin numrin .96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet se për gjyqtaren Alma Kodraliu: -Deklaratat e interesave privatë periodike/vjetore 2017-2019 janë dorëzuar brenda afateve ligjore. -Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave privatë janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit, -Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave;*

Sa më sipër, duke u bazuar në burimet e mësipërme të vlerësimit, ndaj gjyqtares Alma Kodraliu nuk rezultuan të dhëna negative në lidhje me të gjitha komponentët e integritetit.

Gjyqtarja dhe zv/kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares shfaqjen e

sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtares.

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtares, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.*

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk u konstatua përdorimi i gjuhës diskriminuese apo tendencë për paragjykime gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të gjyqtares subjekt vlerësimi. Gjuha e përdorur është korrekte. Asnjë prej dokumenteve ligjorë të vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të pakicave apo të të miturve. I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtaren Alma Kodraliu në vitin 2017 gjyqtarja ka pasur 7 kërkesa për përjashtimin e saj, nga të cilat 3 janë pranuar dhe 4 janë rrëzuar, ndërsa ka pasur për vitin 2017- 6 kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 5 janë pranuar dhe 1 është rrëzuar. Në vitin 2018 gjyqtarja ka pasur 3 kërkesa për përjashtimin e saj, nga të cilat 1 është pranuar dhe 2 janë rrëzuar, ndërkohë ka pasur 17 kërkesa për heqje dorë nga gjykimi, nga të cilat 15 janë pranuar dhe janë 2 janë rrëzuar. Gjithashtu sipas të dhënave statistikore rezulton se edhe për vitin 2019 gjyqtarja ka pasur 11 kërkesa për përjashtimin e saj, nga të cilat 2 janë pranuar dhe 9 janë rrëzuar, ndërsa rezultojnë 7 kërkesa për heqje dorë, të cilat janë pranuar të gjitha.

Referuar metodologjisë për të vendosur nëse numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është apo jo “tejet i lartë”, vlerësuesi, rast pas rasti, nuk përqendrohet vetëm në numrin e vendimeve të pranuar për përjashtimin e gjyqtarit, por analizon dhe krahason edhe tregues të tjerë të dalë nga burimet e vlerësimit, si për shembull raportin ndërmjet kërkesave për heqje dorë të paraqitura nga gjyqtari, me kërkesat e pranuar të palëve për përjashtimin e tij.

Gjyqtarja dhe zv/kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar numrin e kërkesa të pranuar për përjashtim si të pa konsiderueshëm.

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, nga 21 kërkesa të paraqitura për përjashtimin e saj janë pranuar vetëm 6 prej tyre, si dhe nga 30 kërkesa për heqje dorë të paraqitura nga gjyqtarja janë pranuar 27 të tilla, pra e ndarë në 3 vite të periudhës së vlerësimit 2017-2019 vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës është “I pakonsiderueshëm”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër është “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Nivelin i vlerësimit KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit Dritan Hasani në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se gjyqtarja subjekt vlerësimi, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, konstatohet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e

kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Gjyqtarja dhe zv/kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarës në nivel shumë të lartë.

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja Alma Kodraliu në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “I lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja dhe zv/kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të tij me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore.

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtari dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtarja ka komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e në 17 (shtatëmbëdhjetë) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës (10 në rolin e pjemarrësit dhe 7 në rolin e lehtësuesit), të konvertuar në numër ditësh 44 (dyzet e katër) ditë pasi sipas Ligji numrin .96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” në pikën 3 të nenit 5 të tij parashikon se “Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë 5 viteve...”

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 17 aktivitete të zhvilluara për 44 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime është nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se gjyqtarja është angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses në 7 (shtatë) aktivitete trajnues brenda Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës kjo sipas informacionit të përcjellë prej Shkollës së Magjistraturës me shkresën nr. 327 /1 prot., datë 20.05.2021 rezultojnë që gjyqtarja ka marrë pjesë me cilësinë e lehtësuesit në 7 (shtatë) aktivitete trajnuese për trajnimin e gjyqtarëve (të detajuara në treguesin IV.C.a).³⁹

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren Alma Kodraliu duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësueses në 7 aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se në treguesin "Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve" gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë të dhëna për periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) në lidhje me angazhimin e saj në mësimdhënie. Konkretisht referuar vërtetimit me nr. 2219 prot., datë 19.07.2023 të lëshuar nga Universiteti Europian i Tiranës, rezultojnë se znj. Alma Kodraliu është angazhuar si pedagoge me kohë të pjesshme pranë Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, për semestrin e parë për periudhën 2018-2019.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj.

³⁹ Në datë 21.07.2023 me shkresën protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 4251 prot., datë 21.07.2023, gjyqtarja subject vlerësimi ka paraqitur Botimin e vitit 2019 "Standardet e gjyqimit civil, administrative dhe penal përmes vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë", vërtetimin e Shkollës së Magjistraturës nr. 528/1, datë 19.07.2023 si dhe vërtetimin e Universitetit Europian të Tiranës nr. 2219 prot., datë 19.07.2023, të cilat janë administruar dhe janë bërë pjesë e dosjes së vlerësimit të gjyqtares Alma Kodraliu.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarëve në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, rezulton se gjatë vitit 2019 gjyqtarja ka ribotuar me titullin “Standardet e gjyqimit civil, administrativ dhe penal përmes vendimeve unifikues dhe njësues të Gjykatës së Lartë (2000-2019), në bashkautorësi, me ISBN 978-9928-05-267-4. Për rrjedhojë, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se në treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtarit, duke e pikëzuar me 5 pikë.

Nivelin i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

NIVELIN I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Në këtë pjesë, relatori, bazuar në parashikimet e nenit 93, pika 5, shkronja “c” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi bazën e pikëzimit të kryer prej tij, propozon nivelin e vlerësimit për secilin nga katër kriteret e vlerësimit si dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit të gjyqtarit.

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	97	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	100	Shkëlqyeshëm

Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	397	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN ALMA KODRALIU PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2017 - 31 DHJETOR 2019

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT				Pikët total	Niveli i vlerësimit	
				100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë		
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
B. Arsytimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë	

		3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim			Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë	
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë	
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT					Pikët total	Niveli i vlerësimit
					97	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	11-20 %	12	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë	
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%	5	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë	

	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+ 99%	10	Tej standardit : Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural

					për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i	Pikët	Metodologjia

			treguesit		
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparencja e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave 	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave 	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari 	15-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4

	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
NIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			397		
IVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			Shkëlqyeshëm		

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

